



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8115

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: Z.LUFTIM VANI
SHOQERIA "VANI" SHPK
LAGJIA PARTIZANI, RRUGA KUVENDI I DUKAGJINIT,
NDERTESE PRIVATE 3 KATESHE, PERBALLE GJIMNAZIT

BURREL

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1185/1 date 06.01.2012.

I nderuar z. Vani,

Shoqëria "Vani" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1185/1 date 06.01.2012, për mineral Kromi, ne objektin "Qafe Ujku", Klos, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.8156 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimi nr.1185/1 date 06.01.2012, për mineral Kromi, ne objektin "Qafe Ujku", Klos, Qarku Dibër, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2013-2014, vitin 2014-2015 dhe vitin 2015 - 2016.

Për dy vitet e para janë kryer pagesat, pas marrjes se njoftimit nga AKBN-ja për propozimin e dërguar paranë Ministrisë se Energjisë dhe Industrisë, me date 18 shtator 2015, ndërsa për vitin 2015 -2016 nuk është kryer pagesa.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germen "ç" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes**

minerare te shfrytëzimit nr.1185/1 date 06.01.2012, për mineral Kromi, ne objektin “Qafe Ujku”, Klos, Qarku Dibër, qe shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes nr.1185/1 date 06.01.2012, për mineral Kromi, ne objektin “Qafe Ujku”, Klos, Qarku Dibër.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

